



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 501/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë rinumërimit të fletëvotimeve në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 24.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET pjesërisht e bazuar ankesa Anr.501/2019 e datës 22.11.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), që 1 (një) fletëvotim në Vendvotimin 2110B/01R, të vlerësohet i pavlefshëm, dhe i njëjti të largohet nga votat e vlefshme dhe rezultati përfundimtar i publikuar me datë 07.11.2019.

II. REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.501/2019 e datës 22.11.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në pjesën që ka kërkuar ankuesi që në Vendvotimin 2110B/01R, të shpallet 1 (një) fletëvotim i pavlefshëm.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 22.11.2019, ka pranuar ankesën Anr.501/2019 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendohet se më datë 21.11.2019, rreth orës 19:00 në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë procesit të rinumërimit të votave, konkretisht në Vendvotimin 2110B/01R, janë shpallur dy fletëvotime të vlefshme në kundërshtim me nenin 7 të Rregullës Zgjedhore 06/2013. Në njërin prej fletëvotimeve të kontestuar është shënuar shenja “tik”, në katrorin e subjektit politik “NISMA”, mirëpo brenda katrorit të subjektit politik “Jedinstvena Goranska Partija” (JGP), është shënuar një vizë. Ndërsa në fletëvotimin tjetër të kontestuar brenda katrorit të subjektit politik “NISMA”, është shënuar shenja “tik”, kurse brenda katrorit të subjektit politik “AAK-PSD”, është shënuar një vizë në formë “tiku”. Më tutje parashtruesi i ankesës thekson se mënyra se si është bërë ky shënjim i këtyre shenjave e bënë të pavlefshëm fletëvotimin në kuptim të nenit 7 par.2 pika b) si dhe par.3 të këtij neni të Rregullës Zgjedhore 06/2013 të KQZ-së, pasi që ky veprim e bënë të kontestueshëm dhe të paqartë qëllimin e votuesit sepse brenda një fletëvotimi është votuar më shumë se një herë, andaj kërkojmë nga PZAP që të urdhëroj KQZ-në, që t’i shpallë të pavlefshme këto fletëvotime në

kutinë e votimit 2110B/01R, dhe të njejtit të mos i përfshijë në rezultatin përfundimtar zgjedhor të datës 07.11.2019. Si dëshmi për pretendimet e tyre ankesës i kanë bashkangjitur kopjet e fletëvotimeve të kontestuara.

Në përgjigje në ankesë të datës 23.11.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve thekson se në Vendvotimin 2110B/01R një fletëvotim është shpallur i vlefshëm për arsye se kemi vendimin e PZAP-së të datës 19.11.2019 ku thotë se kur shihet qëllimi i qartë i votuesit, ai fletëvotim të shpallet i vlefshëm. Ndërsa në rastin e dytë shihet se tek subjekti 112 ka shenjën tik kurse subjekti 119 në katror ka shenjën pikë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provës së bashkangjitur në ankesë dhe hetimit në QNR në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar

Ankuesi ka paraqitur pretendimin se në kuptim të nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenit 8 par.1 të Rregullës Zgjedhore Nr.06/2013, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, ku ka kërkuar nga PZAP-i, që këto dy fletëvotime në kutinë e votimit 2110B/01R të shpallen të pavlefshme sepse bien në kundërshtim me nenin 7 të Rregullës Zgjedhore 06/2013.

Paneli në bazë të konstatimit zyrtar nga ekipi hetimor i PZAP-së, vërteton se qëndron pretendimi i ankuesit sa i përketë pjesës se në Vendvotimin 2110B/01R është shpallur një fletëvotim i vlefshëm në kundërshtim me nenin 7 të Rregullës Zgjedhore 06/2013, pasi që në fletëvotimin e kontestuar është shënuar shenja “tik”, në katrorin e subjektit politik “NISMA”, ndërsa brenda katrorit të subjektit politik “Jedinstvena Goranska Partija” (JGP), është shënuar një vizë, dhe si të tillë të njejtin Paneli e pranoi të bazuar sikur në pikën -I- të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli, me rastin e pranimit të ankesës, ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga ankuesi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, Paneli ka gjetur se nuk qëndron pretendimi i ankuesit sa i përketë pjesës se në Vendvotimin 2110B/01R është shpallur një fletëvotim i vlefshëm në kundërshtim me nenin 7 të Rregullës Zgjedhore 06/2013, pasi që në fletëvotimin e kontestuar brenda katrorit të subjektit politik “NISMA” është shënuar shenja “tik”, kurse brenda katrorit të subjektit politik “AAK-PSD”, është shënuar një vizë në formë “tiku”, dhe kështu në bazë të konstatimit zyrtar nga ekipi hetimor i PZAP-së, është konstatuar se brenda kutisë së votimit 2110B/01R konkretisht në dengun e fletëvotimeve të vlefshme të subjektit politik NISMA&AKR&PD, nuk është gjetur asnjë fletëvotim i tillë siç pretendohet në ankesë, dhe të njejtin Paneli e refuzoi të pa bazuar sikur në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, “PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze”, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rezultati që del nga pavlefshmëria e fletëvotimit të vendosur si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, e të cilin fletëvotim e gjeni të bashkangjitur në këtë vendim, duhet të largohet nga votat e vlefshme dhe rezultati përfundimtar i publikuar me datë 07.11.2019.

Nga sa u tha më sipër e në kuptim të nenit 117 dhe nenit 118.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.












Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 501/2019 më datën 24.11.2019



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

AN 501

211 B/01R

- 116.  PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS
- 117.  POKRET ZA GORA - PG
- 118.  NOVA DEMOKRATSKA STRANKA - NDS
- 119.  AAK- ~~PSD~~ PSD - KOALICIONI 100% KOSOVAR
- 120. SLOBODA
- 121.  SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA - SL
- 122.  NISMA SOCIALDEMOKRATE  ALEANCA
- 123.  JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA - JGP
- 124.  KOALICIJA VAKRAT
- 125.  FJALA
- 126. LËVIZJA VETËVENDOSJEI
- 127.  KOSOVA DEMOKRATIK TÜRK PARTISI - KTD



ZGJEDHJE

DIM E RI POLITIKES SE KOSOVES 2019
NE REPUBLIKE KOSOVO 2019

1 Shenjtoni VETEM NË subjekt politik
Ozrmedha SAMO JEDAN politicki subjekt!

2 Shenjtoni ME SHUMI PËSE kandidati
Ozrmedha NJËVITE PËR kandidata

111. PARTIA LIBERALE EQJIPTIANE - PLE

112. POK PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK

113. POK PARTIA E ASHKALINJEVE PËR INTEGRIM - PAI

114. STRANKA DEMOKRATIKE AKCIE - SDA

115. PARTIJA KOSOVSKIH SRBA - PKS

116. PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS - PDAK

117. POKRETI ZA GORA - PG

118. NOVA DEMOKRATSKA STRANKA - NDS

119. AAK - PSD - KOALICIONI 100% KOSOVË

120. SLOBODA

121. SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA - SLS

122. NISMA SOCIALDEMOKRATË ALEANCA KOSOVA E RE PARTIA E DREJTËSISË

123. JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA - JGP

124. V KOALICIA VAKAT

125. FJALLA

126. LËVIZJA VETËVENDOSJEI

127. KOSOVA DEMOKRATIK TURK PARTISI - KDTP

128. PARTIA ROMË E BASHKUDAR E KOSOVËS - PREBK

129. PARTIA EUROATLANTIKE E KOSOVËS - PEK

130. KONGRESI NEVI ROMANI PARTIA - KNRP

131. INICJATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS - IRDK

ESMIR KAJI

SHADANSKA INICJATIVA GORE - DIG

...

...

...

1 2 3 4

5 6 7 8

9 10 11 12

13 14 15 16

17 18 19 20

21 22 23 24

25 26 27 28

29 30 31 32

33 34 35 36

37 38 39 40

41 42 43 44

45 46 47 48

49 50 51 52

53 54 55 56

57 58 59 60

61 62 63 64

65 66 67 68

69 70 71 72

73 74 75 76

77 78 79 80

81 82 83 84

85 86 87 88

89 90 91 92


93 94 95 96

97 98 99 100

101 102 103 104

105 106 107 108

109 110



ZABELEŽJE

DIM E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2019
INHO REPUBLIKË KOSOVO 2019

1 Shenjtoni VETËM NJË subjekt politik.
Oznozëte SAMO JEDIN politik subjekt!

2 Shenjtoni NJË SË SHUMTI përgj. numërdor!
Oznozëte NJËRIJË PËT lundëtorë!

111. PARTIA LIBERALE EGIPTIANE - PLE

112. POK PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - POK

113. POK/PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM - PAI

114. STRANKA DEMOKRATIKE AKCUE - SDA

115. PARTIA KOSOVSKE SRBA - PKS

116. PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKALINJËVE TË KOSOVËS - PDAK

117. POKRET ZA GORA - PG

118. NOVA DEMOKRATSKA STRANKA - NDS

119. AAK - PSD - KOALICIONI 100% KOSOVË

120. SLOBODA

121. SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA - SLS

122. NISMA SOCIALDEMOKRATË ALEANÇA KOSOVA E RE PARTIA E DREJTËSISE

123. JEDINSTVENA GORANSKA PARTIA - JGP

124. KOALICIONA VAKAT

125. FJALA

126. LEVIZJA VETEVENDOSJEI

127. KOSOVA DEMOKRATIK TURK PARTISI - KDTP

128. PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS - PREBK

129. PARTIA EUROATLANTIKE E KOSOVËS - PEK

130. KOSOVIANI NEVI ROMANI PARTIA - KNRP

131. INICIATIVIA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS - IRDK

132. ESMIR KABI

133. QADAVANSKA INICIATIVIA GORE - GIG

134. LEVIZJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - LDK

135. AAK-PSD

1 2 3 4

5 6 7 8

9 10 11 12

13 14 15 16

17 18 19 20

21 22 23 24

25 26 27 28

29 30 31 32

33 34 35 36

37 38 39 40

41 42 43 44

45 46 47 48

49 50 51 52

53 54 55 56

57 58 59 60

61 62 63 64

65 66 67 68

69 70 71 72

73 74 75 76

77 78 79 80

81 82 83 84

85 86 87 88

89 90 91 92

93 94 95 96

97 98 99 100

101 102 103 104

105 106 107 108

109 110